


Zinxhiri i diturisë në sqarimin e çështjeve të metodologjisë (Menhexhit) – Pjesa 6

Darul-Kufr dhe Hixhreti

Falënderimet i takojnë All-llahut, Zotit të botëve, përfundimi i mirë është për të devotshmit dhe nuk ka armiqësi, përveç se ndaj zullumqarëve.

Dëshmoj se nuk ka Zot që meriton të adhurohet përveç All-llahut, të vetmit dhe të pa shoq, Sunduesi i vërtetë, dhe dëshmoj se Muhamedi ﷺ është rob dhe i dërguari i Tij, imami i të parëve dhe të fundmëve.

Dhe në vazhdim:

Në këtë pjesë do të flasim për dy kërkime me lejen e All-llahut ﷻ :

E para: Shtetet dhe dispozitat e tyre.

E dyta: Hixhreti dhe dispozitat e tij.

Në çështjen e parë në kërkimin e shteteve do t'i përmendim disa gjëra:

E para: Kuptimi i fjalës Ed-Dar (Shtet) dhe ndarja e botës në dy shtete.

E dyta: Dispozita e shtetit Islam dhe shtetit të kufrit.

E treta: Shkaku i dispozitës së shtetit Islam dhe të kufrit.

E katërta: Llojet e shtetit të kufrit.

Kurse në çështjen e hixhretit do të përmendim disa gjëra:

E para: Dispozita e hixhretit.

E dyta: Dispozita e atij që e braktis hixhretin.

E treta: Gjendja e atyre të cilët qëndrojnë në vendin e kufrit.

Fillojmë me kërkimin e parë me lejen e All-llahut, e cila ka të bëjë me dispozitën e shteteve.

Çështja e parë nga kërkimi i parë:

Kuptimi Ed-Dar (vend/shtet) dhe ndarja e dynjasë në dy shtete dhe kuptimi i shtetit në terminologji:

Dijetarët e Selefëve, të parët dhe të fundit e kanë ndarë dunjanë në dy shtete: Në Shtet Islam dhe shtet i kufrit, kjo ndarje është ndarje bazike e ndërtuar në librin e All-llahut dhe Sunetin e të Dërguarit ﷺ.

Nga libri i All-llahut, fjala e All-llahut:

"Edhe ata që përgatitën *vendin* (Medinen) dhe besimin para tyre, i duan ata që shpërnguleshin tek ata dhe nuk ndiejnë në gjokset e tyre ndonjë nevojë (për zili a tjetër) nga ajo që u jepej atyre (muhaxhirëve), madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetvetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar." [1]

Imam Ibn Kethiri, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Kanë jetuar në shtetin e hixhretit para muhaxhirëve dhe besuan para shumë prej tyre.” Përfundon fjala e tij.

"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetes ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të pa’aftë në atë tokë!" (engjëjt) ju thanë: "A nuk ishte e gjerë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e të praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehenemi dhe sa vend i keq është ai!" [2]

Hixhra, nëse përmendet në Kur'an dhe Sunet e ka për qëllim shpërnguljen prej shtetit të kufrit në shtet Islam, kurse sa i përket Sunetit ka ardhur ndarja e shteteve në shumë hadithe dhe prej tyre është hadithi të cilin e transmeton Muslimi nga Burejde el-Husejn, All-llahu qoftë i kënaqur me të, merfu, ku thotë: *"...pastaj thirri në Islam, nëse ata të përgjigjën pranoi ata dhe ndalu nga ata, pastaj thirri ata që të shpërngulen prej shtetit të tyre në shtetin e muhaxhirëve dhe tregoju atyre se nëse ata e veprojnë këtë, atyre ju takon ajo çfarë ju takon muhaxhirëve dhe ata duhet ta kryejnë atë çfarë e kryejnë muhaxhirët."*

Një hadith të cilin e ka nxjerrë Nesaiu me zinxhir të saktë nga Xhabir ibn Zejd, All-llahu qoftë i kënaqur me të, thotë: "Ibn Abasi, All-llahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë se: Pejgamberi ﷺ, Ebu Bekri dhe Umeri ishin nga muhaxhirët, sepse ata i braktisën mushrikët dhe prej ensareve

1 Surja Hashr, Ajeti 9.
2 Surja En-Nisa, Ajeti 97.

kishte muhaxhirë, sepse Medineja ishte vend i shirkut. Erdhën tek Pejgamberi ﷺ, natën e Akabes."

Çështja e dytë prej kërkimit të shteteve:

Terminologjia e shtetit Islam dhe shtetit të kufrit.

Shtet Islam është çdo vend apo pjesë e tokës në të cilin gjykohet me dispozita të Islamit, forca dhe fjala është për Muslimanët edhe nëse shumica prej banorëve janë jobesimtarë, kurse shtet i kufrit është çdo vend apo pjesë e tokës në të cilën gjykohet me dispozitat e kufrit dhe forca e fjala është për jobesimtarët edhe nëse shumica e banorëve të atij vendi janë Muslimanë.

Imam Ibn Kajimi, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Shtet Islam është ai vend në të cilin banojnë Muslimanët dhe gjykohet me ligjet e Islamit, nëse nuk gjykohet me ligjet e Islamit nuk llogaritet shtet Islam edhe nëse Muslimanët jetojnë në atë vend. Ky grup është i afërm me Meken, mirëpo as Mekeja nuk ishte shtet Islam, edhe pse banonin në të i Dërguari ﷺ dhe sahabet, derisa u çlirua, po ashtu edhe Gadishulli Arabik." [3] Përfundoi fjala e tij.

Imam Ibn Muflih, All-llahu e mëshiroftë, thotë, "Në kaptinën se kur konsiderohet shtet Islam dhe kur shtet i luftës: "Çdo shtet në të cilin sundojnë ligjet e Muslimanëve është shtet Islam, nëse në të sundojnë ligjet e kufrit është shtet i kufrit, dhe nuk ka lloj tjetër përveç këtyre dyjave." [4] Përfundoi fjala e tij.

Çështje e tretë:

Shkaku i dispozitës për gjykimin e shtetit me Islam apo kufr.

3 Ahkam Ehl Edh-Dhimah, v. 2, f.728.
4 Al-Adab esh-Sharijah val-Manh al-Marijah, v. 1, f. 190.

Duke i lexuar thëniet e dijetarëve qartësohet se ata i kanë përmendur dy shkaqe për të gjykuar një shtet:

E para: Forca dhe pushteti.
E dyta: Llojet e dispozitave që zbresin mbi të.

Ibn Hazmi, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Thënia e Pejgamberit: *'Unë jam i distancuar nga çdo Musliman i cili qëndron në mesin e mushrikëve.'* Kjo e qartëson atë çfarë e kemi thënë.
Me të vërtetë Pejgamberi ka pasur për qëllim shtetin luftues, përndryshe ai përdori puntorë në Hajber dhe që të gjithë ata ishin Jehudë. Gjithashtu, nëse janë Ehlu Dhime nëpër qytete ku nuk përzihet me ta askush, ai person i cili jeton me ta, që të i urdhëroj ata apo të bëjë tregti me ta, nuk quhet qafir, po ashtu nuk quhet mëkatar, përkundrazi është besimtar i mirë. Dhe shteti i tyre konsiderohet shtet Islam, nuk është shtet i shirkut, sepse shteti përkatësohet në sunduesin, gjykatësin dhe pushtetarin në të." [5] Përfundoi fjala e tij.

Nga Ebu Jusuf Muhamed ibn Hasen, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Nëse ata i shfaqin dispozitat e kufrit, atëherë shteti i tyre shndërrohet në shtet të luftës, sepse vendi përkatësohet tek ne apo tek ata, varësisht nga forca apo pushteti. Në çdo vend në të cilin shfaqet dispozita e shirkut apo forca e tyre, atëherë ai vend është vend i mushrikëve dhe është shtet i luftës. Dhe në çdo vend në të cilin shfaqen dispozitat e Islamit dhe forca është për Muslimanët, konsiderohet shtet Islam, po ashtu." [6] Përfundoi fjala e tij.

Sheukani, All-llahu e mëshiroftë, duke folur për shtetin thotë: "Nëse janë urdhrat dhe ndalesat në shtet për Muslimanët, dhe nuk ka mundësi se kush jeton prej banorëve të tyre të cilët janë jobesimtarë që të shfaqë diçka prej kufrit të tij, përveç se duke marrë leje prej Muslimanëve, ky llogaritët shtet Islam dhe nuk i bëjnë dëm disa cilësi të kufrit që shfaqën në të, sepse nuk janë shfaqur me forcë ato cilësi të kufrit, sikurse që

5 Al-Muhalla, v. 12, f. 126.
6 Al-Mabsut, v. 10, f. 114.

është e dukshme për ata të cilët paguajnë xhizjen prej Jehudeve dhe Krishterëve apo atyre që kanë marrëveshje prej banorëve në qytete Islamike dhe nëse çështja është e kundërt, atëherë edhe shteti është i kundërt." [7] Përfundoi fjala e tij.

Çështja e katërt:

Ndarja e shtetit të kufrit, llojet e shtetit të kufrit.

Shteti i kufrit ndahet nga pozita e kufrit, varësisht nga cila pozitë e shikojmë, a është kufri në të një kohë të gjatë apo është vend i ri:

E para: Është shtet i kufrit aslij (në esencë), dhe ai është që nuk ka qenë më herët shtet Islam, një kohë prej kohëve.

E dyta: Shtet i kufrit Ta'ri, është ai vend i cili më herët ishte shtet Islam, mirëpo është pushtuar nga qafirët apo kanë bërë ride (felëshim) udhëheqësit e atij shteti dhe kanë gjykuar pastaj me ligje të kufrit.

Veçoria e shteteve nuk është veçori e përgjithshme, përkundrazi varësisht se ku shfaqën dispozitat, atëherë ndryshon edhe veçoria, kuptimi i kësaj është se shteti mund të ndryshojë prej një dispozitë në tjetrën, prej dispozitës së kufrit, pastaj pas një kohë të cilësohet me dispozitë shtet Islam, mund të jetë në dispozitë Islam pastaj dispozitën e kufrit, varësisht prej gjykimeve.

Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Llogaritja e vendit shtet kufri, shtet Islam, shtet i imanit, shtet paqësor, shtet i luftës, shtet i nënshtrimit, shtet i kundërshtimit, shtet i besimtarëve apo shtet i mëkatarëve, veçoritë ndërrohen varësisht prej dispozitave që veprohen aty, mund të kalojë prej një veçori tek tjetra, sikurse mund të kalojë vetë personi prej kufrit në iman dhe dituri, po ashtu dhe e kundërta e saj." [8] Përfundoi fjala e tij.

7 As-Sajl al-Xharar, v. 4, f. 575 – 576.
8 Mexhmu el-Fetava, v. 27, f. 45.

Këtu duhet të tërhiqet vërejtja sepse nuk është kusht që në një vend që gjykohet me kufër, pa marr parasysh se, a është shtet në esencë apo ka qenë në pushtetin e Muslimanëve, e tani gjykohet me kufër, të gjykohet me kufër për ata Muslimanë të cilët jetojnë në atë vend, ky mendim është prej gulatëve (tepruesve) dhe është rrugë prej rrugëve të havarixhëve.

Me të vërtetë e ka përmendur Ebu Hasen el-Eshari, All-llahu e mëshiroftë, i cili thotë se ky mendim është i një prej grupeve të havarixhëve: "Kanë pretenduar Ezerikat (fraksion i havarixhëve) se kush qëndron në shtetin e kufrit ai është kafir, dhe nuk ka opsion tjetër veçse të ikë" [9] Ai i cili e ka këtë mendim vetëm se është prej havarixhëve dhe e ka përmendur se havarixhët kanë thënë se "Nëse bën kufër imami, kanë bërë kufër edhe ata të cilët ai i ka nën kujdes, ata të cilët janë prezent dhe ata të cilët nuk janë prezent." [10] Përfundoi fjala e tij.

Kjo është se esenca e Muslimanit është mbetja i tij në Islam mbi çdo tokë dhe ndër çdo qiell derisa nuk vepron ndonjë anullues prej anulluesve të Islamit, çka ndërtohet mbi bindje nuk prishet me dyshim.

Imam Sheukani, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Dije se përmendja e shtetit të kufrit dhe shtetit Islam nuk ka shumë dobi në raport me banuesit në të. Ato çfarë i kemi përmendur më herët në raport me shtetin luftues (Darul Harb) me të vërtetë qafiri i cili është luftues, gjaku i tij dhe pasuria e tij janë të lejuara në çdo formë, përveç se nëse japin siguri Muslimanët dhe se pasuria dhe gjaku i besimtarit janë të ndaluara, për shkak të Islamit të tij, pa marrë parasysh se a jeton në shtetin e kufrit apo diku tjetër." [11]

Dhe se e vërtetë është të thuhet se dispozita e banorëve në shtetin e kufrit, apo fjala se në esencë është Islami apo kufri, apo të thuhet se gjendja e tyre është e panjohur, ka dallim me dallimin e gjendjes. Dhe të

9 Makalat el-Islamijeh, v. 1, f. 88.
10 Makalat el-Islamijeh, v. 1, f. 103.
11 Es-Sejl el-Xharar, v. 1 f. 976.

gjitha këto dispozita janë të fikhut, duhet të iu kthehemi fetave të dijetarëve. Dhe për këtë ka polemik mes thënieve të tyre, varësisht prej gjendjes së banuesve në ato shtete, dhe ne i tregojmë disa shembuj nga kjo:

Shembulli i parë: Fetvaja e Shejhul Islam ibn Tejmijes për banorët e Mardinit

Ishte shtet Islam, e kanë pushtuar atë Tatarët dhe kanë gjykuar me ligje të kufrit.
Është pyetur Shejhul Islam ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, për shtetin e Mardinit se a është shtet luftues apo shtet i paqes dhe se a është obligim për Muslimanët të cilët qëndrojnë aty që të bëjnë hixhret në shtetin Islam apo jo dhe nëse është obligim hixhreti dhe ata nuk bëjnë hixhret apo i ndihmojnë armiqtë e Muslimanëve me vetët e tyre dhe pasurinë e tyre, a kanë mëkat në këtë dhe e a ka mëkat ai i cili i akuzon me nifak apo i fyen ata?

Është përgjigjur:

“Falënderimi i takon All-llahut, gjaku dhe pasuria e Muslimanit janë të ndaluara, pa marrë parasysh se a është në Mardin apo në ndonjë vend tjetër dhe ndihma e atyre të cilët dalin nga ligji i Islamit është e ndaluar, pa marrë parasysh se a janë banorët e Mardinit apo dikush tjetër. Ai i cili jeton në të, nëse është e pamundur për të që ta zbatojë fenë e tij, atëherë është obligim për të hixhreti në të kundërtën është e pëlqyer dhe nuk është obligim.

Ndihma e armiqëve të Muslimanëve me vetet dhe pasuritë e tyre është e ndalur dhe se është obligim për ta që të ruhen nga kjo në çdo mënyrë të cilën kanë mundësi, duke u fshehur apo duke përdorur metoda mashtruese për të mos e vepruar këtë, e nëse nuk munden që ta bëjnë këtë, përveç se me hixhret, atëherë është obligim për ta (farz ajn) që të bëjnë hixhret dhe nuk lejohet fyerja e tyre në përgjithësi me nifak,

përkundrazi akuzimi me nifak duhet të jetë në ata persona të cilët i ka përmendur Kur'ani dhe Suneti dhe hyjnë në të disa prej banorëve të Maridinit apo jashtë tij, mirëpo ekzistenca e tij si shtet luftues apo i paqes është me dy gjëra: Nuk është shtet Islam i paqes në të cilin zbatohen dispozitat e Islamit, dhe të jetë ushtria Muslimane dhe nuk është në dispozitën e shtetit luftues, banorët e të cilit janë qafirë, përkundrazi kjo është në kategorinë e tretë, trajtohet Muslimani në të me çfarë e meriton apo çfarë i takon dhe luftohet ai i cili është kundër sherijatit me atë çfarë i takon.” [12] Përfundon fetvaja e tij.

Shiko se si gjykoi për banorët në atë vend dhe se nuk lejohet që të akuzohen ata në përgjithësi me nifak dhe nuk janë ata qafirë, sikurse banorët të cilët jetojnë në shtetin luftues, me gjithë se ai gjykoi për ushtrinë e tij se nuk janë Muslimanë. Dhe e gjithë kjo ndërkohë që Mardini ishte shtet i kufrit (Ta’ri) i cili ka qenë nën pushtetin e Muslimanëve më herët.

Shembulli tjetër është fetvaja e Hamd ibn Atik, All-llahu e mëshiroftë, për banorët e Ahsait.

Ai tha:

“Dhe kush shikon në atë që janë pajtuar dijetarët, mund ta kuptojë nga ajo se shteti në të cilin shfaqet shirku dhe shfaqen gjërat e ndaluara dhe pengohen mësimet e fesë, llogaritët shtet i kufrit, merret pasuria e tyre dhe gjaku i tyre është i lejuar. Banorët e këtij vendi mund ta shfaqin fyerjen për Të dhe Fenë e tij dhe kanë vendosur kanune, i zbatojnë ato për popullatën, që bien në kundërshtim me librin e All-llahut dhe Sunetin e të dërguarit të Tij. Mund ta kuptosh nga kjo, se kjo është e mjaftueshme që ta nxjerrësh nga Islami atë i cili e vepron këtë, dhe ne themi se ka mundësi që të ekzistoj dikush në të, në të cilin nuk gjykohet me kufër, prej personave të cilët janë te dobët dhe prej kategorisë së tyre. Kurse në pamjen e jashtme çështja është e qartë dhe falënderimi i takon All-llahut dhe të mjafton ty ajo vepra të cilën e ka vepruar Pejgamberi ﷺ

12 Mexhmu el-Fetava, v. 28, p 240.

në Meke, edhe se në të kishte të dobët dhe po ashtu kanë vepruar shumë herë shokët e tij me ata të cilët kanë bërë ride nga Islami, duke u lejuar gjaku dhe pasuria e tyre si dhe duke i marrë rob, dhe çdo njeri që ka logjikë dhe është i ditur e di se kush i vepron këto gjëra nga kufri dhe felëshimi është më keq dhe e shfrenuar dhe më e madhe se ajo të cilën e kanë vepruar ata. Ktheje shikimin në tekstet e Kur'anit dhe Sunetit dhe në historinë e Pejgamberit ﷺ dhe shokëve të tij do ta gjesh të pastër, të bardh, nuk devijon nga ajo përveç ai i cili është i shkatërruar.

Paso fjalët e dijetarëve dhe lute All-llahu ﷻ që të ta udhëzojë zemrën, t'i largojë dyshimet, dhe nuk kam menduar se nga një person sikurse ti, të dalin këto gjëra, dhe mos të mashtrojë ty ajo në të cilën janë injorantët dhe atë çfarë e thonë njerëzit të cilët kanë dyshime." [13]

Shiko si gjykuan për banorët e atij vendi me kufër në pamje të jashtme dhe kjo pasi që u vërtetuan veprimet të cilat e paraqesin këtë gjykim dhe për shkas se kufri tek ta ishte i përhapur dhe i dukshëm dhe gjëra tjera, dhe nuk e lidhën gjykimin mbi ta, për shkak se ata jetuan në shtetin e kufrit. Përfundimi i kësaj është se duhet të bëjmë dallim mes çështjes së dispozitës së shtetit dhe mes çështjes së dispozitës së personit. Mund të jetë dispozita e shtetit varësisht gjykimeve që bëhen në atë shtet dhe të jetë dispozita e banorëve ajo çfarë del prej veprimeve të tyre, kërkojmë ndihmë tek All-llahu.

Përfundon kërkimi i parë në aspektin e shteteve dhe tek All-llahu e kërkojmë udhëzimin.

Tani fillojmë diskutimin rreth çështjes së dytë, dhe është çështja e hixhretit.

Përkufizimi sheriatik i hixhretit: është ta lësh darul-kufrin për në

13 Ed-Durar es-Senijeh, v. 9, f. 257.

darul-Islam për hir të All-llahut. Hixhreti gjithashtu mund të jetë për qëllim në përgjithësi, për të nënkuptuar largimin nga një tokë e mosbindjes në një tokë të bindjes, ose nga një tokë e bidatit në një tokë të Sunetit.

Çështja e parë:

Gjykimi i hixhretit.

Ka thënë Ibn Kasimi, All-llahu e mëshiroftë, në *'Hashijeh ala al-Usul Eth-Thalathah'*, "(Hixhreti) dihet se është vërtetuar nga Libri, Suneti dhe ixhmaja. Ai që e lë, është nën kërcënimin e dënimit. Një numër dijetarësh kanë transmetuar ixhma për detyrimin e hixhretit nga tokat e shirkut në tokat e Islamit. "

Çështja e dytë:

Gjykimi për lënien e hixhretit.

Muslimani nuk bën kufër për braktisjen e hixhretit vetëm, për shkak të thënies së Tij ﷻ, (kuptimi): **"Ata që besuan por nuk u shpërngulën, ju nuk keni përkujdes as ndihmë për ta derisa të shpërngulen edhe ata. E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni, përveç nëse është puna kundër një populli që me të keni marrëveshje (nuk mund t'u ndihmoni në luftë kundër atij populli). All-llahu mbikëqyr atë që vepron."** [14]

Kështu Ai bashkoi midis përshkrimit të imanit dhe braktisjes së hixhretit nga toka e luftës.

14 Surja Enfal, Ajeti 72.

Ebu Bekr ibnul-Arabi, All-llahu e mëshiroftë, tha: “Thënia e Tij ﷻ, (kuptimi): “...**E nëse ata kërkojnë ndihmë prej jush për çështjen e fesë, atëherë jeni të obliguar t'u ndihmoni...”** do të thotë nëse ju thërrasin nga një tokë lufte për t'i ndihmuar ata në një thirrje për armë ose me pasuri për t'i lehtësuar ata, atëherë ndihmojini ata pasi kjo është e detyrueshme për ju, përveç me ata njerëz të cilët kanë një besëlidhje me ju. Nëse ky është rasti, atëherë përmbaheni nga luftimi me ta, deri sa besëlidhja të mbarojë, ose anullohet.” [15]

Gjithashtu nuk është e lejueshme për një Musliman të banojë në darul-kufër nëse ai nuk është në gjendje të praktikojë dhe manifestojë fenë e tij, për shkak të thënies së Tij ﷻ, (kuptimi): **"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetës ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (engjëjt) ju thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e All-llahut e të migronit në të?" (e të praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!" [16]**

Ibn Kethiri, All-llahu e mëshiroftë, tha: “Ajeti fisnik është i gjerë në përshkrim për të gjithë ata që banojnë në mesin e mushrikëve, ndërsa janë të aftë për të bërë hixhret dhe të pa’aftë për të praktikuar fenë e tyre. Një person i tillë po bën padrejtësi ndaj vetvetes dhe po bie në haram me konsensus.”

Manifestimi (praktikimi) i fesë nuk është thjesht aftësia për të falur namazin dhe të ngjashme me të. Ajo që synohet me manifestimin e fesë, është shfaqja e urrejtjes dhe armiqësis ndaj kufarëve dhe mushrikëve, për shkak të thënies së Tij ﷻ, (kuptimi): **“Ju e keni shembullin më të mirë te Ibrahimi dhe te ata që ishin me të, kur i thanë popullit të vet: "Ne tërhiqemi prej jush dhe prej asaj që adhuroni, pos All-llahut, nuk besojmë tuajën, prandaj ndërmjet nesh e jush është e hapët armiqësia e urrejtja derisa ta besoni vetëm All-llahun, Një!”** [17]

15 Ahkam al-Kuran, v. 2, f. 439.
16 Surja Nisa, Ajeti 97.
17 Surja Mumtehine, Ajeti 4.

Ndërsa ai që lë hixhretin ndërsa është me të asli (baza) e armiqësisë - kuptimi, armiqësia është e pranishme dhe gjendet (brenda tij) - megjithatë, ai nuk e tregon atë - do të thotë, ai nuk e bën të dukshme - atëherë ai është mëkatar, por jo kafir.
Shejh Abdul-Latif , All-llahu e mëshiroftë, u pyet për këdo që është nën autoritetin e mushrikëve dhe e njeh teuhidin dhe vepron sipas tij, megjithatë ai nuk ka armiqësi ndaj atyre as nuk largohen nga tokat e tyre.

Ai u përgjigj:

“Kjo pyetje vjen për shkak të mungesës së reflektimit në këtë çështje dhe mbi kuptimin e synuar të teuhidit dhe të vepruarit sipas tij. Sepse nuk mund të imagjinohet dikush që e di teuhidin dhe vepron sipas tij, e të mos i përbuzë mushrikët. Kushdo që nuk i urren ata, nuk mund të thuhet se ai e di teuhidin dhe vepron sipas tij. Kështu që pyetja është kontradiktore. Pyetja e mirë është çelësi për diturin, dhe mendoj se qëllimi yt është kush nuk e shfaqë armiqësinë dhe nuk e lë vendin e tij dhe çështja e shfaqjes së armiqësisë është tjetër çështje nga çështja e ekzistencës së armiqësisë. Në të parën arsyetohet ai që nuk ka mundësi dhe ka frikë, siç thotë All-llahu (kuptimi): **"...përveç nëse është për qëllim ruajtja prej të keqes së tyre…"** [18] sa për të dytën, patjetër që armiqësia të jetë prezentë, kjo hyn në kufër në tagut (mohimin e tagutit) dhe mes tij dhe mes dashurisë për All-llahun dhe të dërguarit të Tij, pa të cilën një besimtar nuk mund të bëjë. Kjo duhet të jetë patjetër e gjitha, nuk ndahet nga besimtari, dhe kush e kundërshton All-llahun me mos shfaqjen e armiqësisë ai është mëkatar ndaj All-llahut, mirëpo nëse ekziston esenca e armiqësisë në zemrën e tij, ai e ka dispozitën e atyre të ngjashmëve me të prej mëkatarëve dhe nëse i shtohet kësaj mos hixhreti ai e ka një pjesë të fjalës së All-llahut ku thotë (kuptimi):
"Engjëjt që ua morën shpirtin e atyre që ishin mizorë të vetvetës ju thanë: "Në çka ishit ju? - Ata thanë: "Ne ishim të paaftë në atë tokë!" (engjëjt) ju thanë: "A nuk ishte e gjërë toka e All-llahut e të

18 Surja Ali Imran, Ajeti 28.

migronit në të?" (e të praktikonit lirisht fenë e Zotit). Vendi i tyre është xhehennemi dhe sa vend i keq është ai!" [19]

Mirëpo nuk bën kufër, sepse ajeti është kërcënim, nuk është që të llogaritet qafir, kurse e dyta ai i cili nuk ka asgjë në zemrën e tij prej armiqësisë, dhe është e vërtetë pyetja e personit i cili e bën se nuk i armiqëson mushrikët, kjo është çështje e madhe, është mëkat i madh dhe çfarë mirësie ngel nëse nuk ka armiqësi ndaj qafirëve. Të frikohesh për hurmat dhe banimet nuk është arsyetim që ta braktisësh hixhretin, All-llahu thotë (kuptimi): **"O robët e Mi që besuat, toka Ime është e gjerë, pra vetëm Mua më adhuroni."** [20] [21] Përfundon fjala e tij.

Kurse sa i përket braktisjes së hixhretit prej shtetit të kufrit duke e miqësuar kufrin dhe pasuesit e tij apo ndihma e tyre kundër Muslimanëve, kjo është kufër, ky është qafir sikurse ata, All-llahu thotë (kuptini): **"O ju që besuat, mos u ofroni miqësi (dashuri) prindërve tuaj, as vëllezërve tuaj, nëse ata vlerësojnë mosbesimin kundër besimit. E kush prej jush miqësohet me ta, ata janë mizorë."** [22]

Kurtubiu, All-llahu e mëshiroftë, thotë: "Ajo çfarë nxirret nga ky ajet i përfshinë të gjithë Muslimanët dhe dispozita e saj mbetet deri në Ditën e Gjykimit, për shkëputjen e miqësisë në mes besimtarëve dhe qafirëve. E ka transmetuar një grup se ky ajet ka zbritur që të nxisë për në hixhret dhe kundërshtim të shtetit të kufrit. Ky ajet iu drejtohet besimtarëve të cilët ishin në Meke dhe në vendet tjera prej vendeve Arabe, iu është drejtuar që të mos i miqësojnë baballaret, vëllezërit e tyre, të cilët ishin banorë në shtetin e tyre. Që të mos jenë pasuesit e tyre banues në shtetin e kufrit." Përfundon fjala e tij.

Ibn Hazmi, All-llahu e mëshiroftë, tha: "Është e saktë se më të vërtetë ai i cili jeton në shtetin e kufrit dhe luftës, dhe me zgjedhjen e tij bëhet

19 Surja Nisa, Ajeti 97.
20 Surja Ankebut, Ajeti 56.
21 Ed-Durar es-Senijah, v. 8, f. 359.
22 Surja Teube, Ajeti 23.

luftëtar (kundër Muslimanëve), kush është prej besimtarëve ai me këtë vepër ka bërë ride (felëshim), ai i ka dispozitat e murtedit të gjitha, është obligim që të vritet kur të jetë e mundur dhe është pasuria e tij hallall, ndahet nga gruaja e tij. Kjo ngase Pejgamberi ﷺ, nuk është distancuar nga Muslimani.” [23] Përfundon fjala e tij.

Ibn Tejmije, All-llahu e mëshiroftë, duke shtuar rreth asaj se çfarë është transmetuar nga Abdullah ibn Umer, All-llahu qoftë i kënaqur me të, thotë: "Kush vendoset në shtetin e tyre apo feston festat e tyre apo për ngjason me ta derisa të vdesë, do të ringjallet me ta.” Tha; kjo tregon se ai e bëri qafir për shkak të bashkëngjitjes në të gjitha këto gjëra, apo këtë e konsideroi prej gjunaheve më të mëdha, të cilat e obligojnë dënimin me zjarr. Edhe pse e para është ajo çfarë shihet prej shprehjes së tij, pjesmarrja në disa nga këto është mëkat.” [24] Përfundon fjala e tij.

Çështja e tretë: Gjendja në shkallë të ndryshme e atyre të cilët qëndrojnë në shtetin e kufrit.

Ibn Hazmi, All-llahu e mëshiroftë, tha:

"Kush ikën në shtetin i kufrit (i luftës) prej zullumit të cilit i frikësohet ai, dhe nuk i lufton Muslimanët dhe nuk i ndihmon ata kundër tyre dhe nuk gjen prej Muslimanëve kush ta mbrojë atë, ky person nuk ka mëkat sepse është i detyruar, këtë e kemi përmendur se Zuhri Muhamed ibn Muslim ibn Shehebe, ishte i vendosur se kur të vdesë Hisham ibn Abdul Melik do të ikte në shtetin Romak, sepse El Velid ibn Jezid ka thënë ‘do ta vras atë nëse kam mundësi’, dhe ai ishte për t’u bërë Veli pas Hishamit dhe kush e ka gjendjen e tij, ai është i arsyetuar.

Dhe po ashtu ai i cili jeton në Indi, Pakistan, Kinë, Turqi, Sudan apo në vendet Romake (Evropiane), nëse nuk ka mundësi të dalë nga ai vend për shkak se nuk ka mundësi apo pasuri apo është i dobët në trup apo

23 El-Muhalla, v. 6, f. 47.
24 Iktida es-Sirat el-Mustekim, v. 1, f. 515.

ndonjë pengesë në rrogë, ai është i arsyetuar.

Nëse është luftues ndaj Muslimanëve, i ndihmon mosbesimtarët me ndonjë shërbim apo letër, ai është mosbesimtar.
Mirëpo nëse qëndron për dunja, ai llogaritet sikurse Dhimij (shërbëtor) i tyre dhe nëse ai ka mundësi të i'u bashkëngjitet Muslimanëve në tokën e tyre, nuk është larg kufrit dhe nuk shohim te ai arsyetim. E lusim All-llahun që të na fal.

Nuk është e njëjtë sikurse ai i cili jeton ndër pushtetin e mosbesimtarëve në El Galije (fshat në Saudi) dhe të ngjashmit me ta, sepse Egjipti, Kajravani dhe të tjerat përveç tyre, këtu Islami është i shfaqur dhe mbizotëron dhe udhëheqësit e tyre nuk e shfaqin distancimin e tyre nga Islami, kurse ata përkundrazi përkatësohen në Islam edhe pse realiteti i tyre është se ata janë mosbesimtar.

Kurse sa i përket atyre që jetojnë në tokën e Keramitëve (Ismaili, sekt i Shiave) me vetë dëshirë ai është mosbesimtar pa dyshim, sepse ata e shfaqin kufrin dhe braktisjen e Islamit, kërkojmë mbrojtje nga All-llahu prej kësaj.

Kurse sa i përket atij i cili jeton në një vend në të cilin shfaqen disa gjëra që të dërgojnë në mosbesim atëherë ky nuk është mosbesimtar, sepse shfaqet emri i Islamit këtu në çdo mënyrë prej te Teuhidi, pranimi i pejgamberisë se Muhamedit ﷺ, distancimi nga çdo fe përveç Islamit, falja e namazit, agjërimi dhe të gjitha dispozitat tjera të Islamit dhe imanit. Falënderimi i takon All-llahut." [25] Përfundon fjala e tij.

Paqja qoftë mbi Muhamedin, familjen dhe shokët e tij.

Fundi i pjesës së gjashtë (pjesa e fundit)

25 El-Muhalla, v. 12, f. 125.

